



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2717 / Prot.

Tiranë, më 14. 11. 2025

VENDIM

Nr. 344, Datë 03.11.2025

**“PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI TË PROKURORIT  
MARJETA ZAIMI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

|                    |                     |
|--------------------|---------------------|
| 1. Mirela BOGDANI  | Kryetar             |
| 2. Erind GERMENJI  | Zy/kryetar          |
| 3. Sokol STOJANI   | Anëtar              |
| 4. Zeqir HODA      | Anëtar              |
| 5. Arta MANDRO     | Anëtar (në mungesë) |
| 6. Ledina RIZA     | Anëtar              |
| 7. Moisi DUDA      | Anëtar              |
| 8. Vatë STAKA      | Anëtar (në mungesë) |
| 9. Olger EMINAJ    | Anëtar              |
| 10. Erind MERKURI  | Anëtar              |
| 11. Erion FEJZULLA | Anëtar              |

Në mbledhjen e datës 03.11.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni të prokurorit Marjeta Zaimi”**

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:**

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2717 prot., datë 30.10.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi Relatorin Arta Mandro, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

## V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit është administruar me nr. 2553 prot., datë 17.10.2025, Kërkesa e magjistratit Marjeta Zaimi, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për kryerjen e veprimtarisë me pagesë jashtë funksioni të prokurorit, si pedagog i jashtëm për lëndën “E drejta familjare, i mituri dhe viktima”, në Shkollën e Magjistraturës.
2. Veprimtaria jashtë funksionit është parashikuar për t’u zhvilluar në mënyrë të alternuar, me një ngarkesë prej një leksioni (ose seminar) në javë, prej 4 (katër) orë mësimore secili.
3. Kohëzgjatja në tërësi e veprimtarisë është 100 (njëqind) orë mësimore (një orë mësimore zgjat 50 minuta, e shpërndarë gjatë një semestri, gjatë vitit akademik 2025-2026. Kjo veprimtari do të ushtrohet nga stafi në përbërje të të cilit do të jenë një pedagog i brendshëm, pesë pedagogë të jashtëm, një specialist dhe dy pedagogë në dispozicion.
4. Bashkëlidhur kërkesës së prokurores Marjeta Zaimi ndodhet e-maili i Shkollës së Magjistraturës, me lëndë “Njoftim për miratimin e pedagogëve në lëndën “Gjykimi familjar, i mituri dhe viktima” për vitin akademik 2025-2026”, si dhe informacioni mbi planin mësimor dhe programin e lëndës.
5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurorja Marjeta Zaimi nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
6. Në këto kushte, ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksioni në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij.
7. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:
  - është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
  - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit.
  - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
  - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.
8. Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i propozoi Këshillit miratimin e kërkesës së prokurores Marjeta Zaimi për të qenë pedagog i jashtëm për lëndën “E drejta familjare, i mituri dhe viktima”, gjatë vitit akademik 2025-2026, në Shkollën e Magjistraturës.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

## VENDOSI:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Marjeta Zaimi si pedagog i jashtëm për lëndën “E drejta familjare, i mituri dhe viktima”, në vitin akademik 2025-2026, në Shkollën e Magjistraturës.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Marjeta Zaimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 03.11.2025.

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
Mirela Bogdani

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
Erion Fejzulla

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
Olger Eminaj

**ZV/KRYETAR**  
Erind Germenji

**ANËTAR**  
Ledina Riza

**ANËTAR**  
Erind Merkuri